USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA

GJAKOVA

epublika e Kosovës - Republika Kosova
omuna e Gjakovës - Opština Djakovica
Drejtoria për Punë të Përgjithshme Administratë
Uprava za Opšte, Administrativne Poslove
01 Nr./Br.- 052101- 15027
Data/Datum 13.06.2021
Gjakovë-Djakovica-Gjakova

# PLANI I PUNËS
# KOMUNA E GJAKOVËS

Janar 2021 - Dhjetor 2021

Programi i USAID-it Komunat Transparente, Efektive dhe Llogaridhënëse

PËRMBAJTJA

Përmbajtja

SHKURTESAT....4

HYRJE....5

PLANI I PUNËS SË KOMUNËS SË GJAKOVËS....7

ÇËSHTJE TJERA....8

REZULTATET E PRITURA....8

1.1 REALIZIMI I VLERËSIMIT VJETOR, ANKETËS DHE PLANIFIKIMI I AKTIVITETE....9

1.1.1 Përpilimi i planit të përshtatur të punës për komunën e Gjakovës për vitin 2021....9

1.1.2 Vlerësimi i kapacitetit organizativ të komunës (VKOK) dhe matja e treguesve të gradimit të komunës - Monitorimi i zbatimit....9

1.1.3 Ndarja dhe diskutimi i rezultateve të vlerësimit të kapaciteteve dhe të rezultateve të gradimit....10

1.2 MONITORIMI I KAPACITETEVE KOMUNALE NË PROKURIM DHE MENAXHIM TË PROJEKTEVE/KONTRATAVE....10

1.2.1 Përkrahje në vend të punës për aktivitetet komunale të prokurimit....11

1.2.2 Monitorimi i aktiviteteve të prokurimit....12

1.2.3 Përkrahje në vend pune për mekanizmat komunalë në përmirësimin e menaxhimit të projektit dhe menaxhimit të kontratës....13

1.2.4 Shpërndarja e praktikave dhe proceseve të prokurimit publik....14

1.3 RRITJA E KAPACITETIT TË NJËSISË KOMUNALE TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM (NJAB) DHE KOMITETIT KOMUNAL TË AUDITIMIT (KKA)....14

1.3.1 Përkrahje në vend pune në fushën e auditimit....14

1.3.2 Monitorim në aktivitetet e auditimit....15

1.3.3. Shpërndarja e praktikave dhe proceseve për të zhvilluar kapacitetet e NJAB dhe KKA....16

1.4 PËRKRAHJA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE KOMUNALE....16

1.4.1 Monitorimi i aktiviteteve në menaxhim të BNJ dhe implementim të kodit të etikës, instrumenteve, mekanizmave nga ciklet e me hershme te projektit....16

1.4.2 Shpërndarja e praktikave dhe proceseve të mira në menaxhimin e burimeve njerëzore....17

1.5 RRITJA E TRANSPARENCËS KOMUNALE....17

1.5.1 Monitorimi i aktiviteteve të transparencës komunale....18

1.5.2 ZBATIMI I STRATEGJISË KOMUNALE PËR KOMUNIKIM ........ 18
1.5.3 Shpërndarja e praktikave dhe proceseve të mira në transparencën komunale ........ 19
1.6 MONITORIMI I MENAXHIMIT FINANCIAR DHE KONTROLLIT ........ 19
1.6.1. PËRKRAHJE NË VEND PUNE PËR PROCESET E MENAXHIMIT TË FINANCAVE PUBLIKE ........ 19
1.6.2 Monitorimi i aktiviteteve për proceset e menaxhimit të financave publike ........ 20
1.6.3 Përkrahje në zhvillimin, ndërtimin dhe zbatimin e mekanizmave (PSO, doracak-manual, forma-shabllone, etj.) financiare ........ 21
1.6.4 Shpërndarja e praktikave të mira për menaxhimin dhe kontrollin financiar ........ 21
Aneksi I: Zhvillimi, Rafinimi dhe Futja në Përdorim e Modeleve për Komuna Transparente dhe Llogaridhënëse ........ 22

## SHKURTESAT

AKK - Agjencia Kundër Korrupsionit

AKM - Asociacioni i Komunave të Kosovës

AK - Autoriteti Kontraktues

ZKF - Zyrtari Kryesor Financiar

NJQH - Njësia Qendrore e Harmonizimit

VKOK - Vlerësimi i Kapaciteteve Organizative të Komunës

OE - Operatori Ekonomik

AB - Auditimi i brendshëm

NjAB - Njësia e Auditimit të Brendshëm

NjKA - Njësia Komunale e Auditimit

MPL - Ministria e Pushtetit Lokal

MF - Ministria e Financave

ZKA - Zyra Kombëtare e Auditimit

OE - Operatorët Ekonomik

KPF – Komiteti për Politikë dhe Financa

MFP - Menaxhimi i financave publike

KRPP - Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik

OSHP - Organi Shqyrtues i Prokurimit

PSO - Procedura Standarde të Operimit

TEAM - Komunat Transparente, Efektive dhe Llogaridhënëse

USAID - Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar

**HYRJE**

Komunat Transparente, Efektive dhe Llogaridhënëse (TEAM) është projekt pesëvjeçar i financuar nga USAID që ka filluar më 11 janar 2017 dhe është planifikuar të përfundojë në janar 2022. Projekti është i dizajnuar që të përmirësojë drejtësinë, transparencën dhe mbikëqyrjen e prokurimit duke ofruar asistencë të plotë në të gjitha 38 komunat e Kosovës, me theks të veçantë në 15 komunat që janë në fokus të projektit përmes mentorimit, trajnimit dhe stërvitjes për të përmirësuar llogaridhënien për fondet dhe shpenzimet publike.

Në nivel qendror, projekti USAID TEAM do ta shfrytëzojë përkrahjen e vet për përpjekjet e komunave kundër korrupsionit, duke punuar ngushtë me një sërë aktorësh në nivel kombëtar - përfshirë edhe Ministrinë e Financave (MF), Ministrinë e Pushtetit Lokal (MPL), Komisionin Rregullativ për Prokurim Publik (KRPP), Zyrën Kombëtare të Auditimit (ZKA), Organin Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), Agjencinë Kundër Korrupsionit (AK-K) dhe Asociacionin e Komunave të Kosovës (AKK) - si dhe me partnerët nga të 38 komunat.

Shoqëria civile gjithashtu luan rol kyç në sigurimin e mbikëqyrjes dhe ndarjen e pushteteve. Duke luajtur rolin e "kujdestarit" (watchdog), ata i ekspozojnë praktikat korruptive në bashkëpunim me qytetarët dhe qeveritë lokale si partner në procesin e modernizimit të prokurimit. Projekti po implementohet në partneritet me rrjetin e Organizatave të Shoqërisë Civile (OSHC) në Kosovë (CiviKos) për ta promovuar transparencën dhe llogaridhënien Ky rrjet do ta përkrahë edukimin dhe përkushtimin e qytetarëve për ta detektuar korrupsionin kur ai ndodh në procesin e prokurimit në nivelin komunal dhe qendror duke ushtruar presion të pandërprerë për ta përmirësuar transparencën. Programi USAID TEAM ka përcaktuar tri objektiva të gjera për të ndihmuar qeveritë komunale, si më poshtë:

- Objektivi 1: Zhvillimi, rafinimi dhe futja në përdorim e modeleve për komuna transparente dhe llogaridhënëse
- Objektivi 2: Angazhimi i nivelit qendror në adresimin e korrupsionit komunal në procesin e prokurimit, dhe
- Objektivi 3: Aktivizimi i shoqërisë civile për ta përcjell dhe ekspozuar korrupsionin.

Projekti USAID TEAM, do të ndihmojë qeveritë komunale të komunave partnere në fokus duke ofruar përkrahje dhe asistencë direkte përmes këshilltarëve të cilët kanë ekspertizë profesionale në fushat: prokurimit publik, menaxhimit të projekteve dhe kontratave publike, auditim, transparencë, menaxhimit të financave publike dhe burimeve njerëzore. Prandaj, TEAM i USAID-it është i përkushtuar ta jep përkrahje e nevojshme për komunat në fokus, në mënyrë që ato të funksionojnë në mënyrë efektive dhe të japin shërbime cilësore për qytetarët e tyre në fushat e lartpërmendura. Për ta arritur objektivin e tij, TEAM i USAID-it e ka krijuar një metodologji për ta vlerësuar gjendjen fillestare në të cilën janë komunat (pikënisja) dhe rezultatet e arritura në vitet e kaluara. Pas çdo cikli të vlerësimit, TEAM i USAID-it së bashku me komunat e shqyrtojnë dhe përpilojnë planin e punës të komunës i cili synon arritjen e nivelit të kërkuar të gradimit dhe të japë rezultate më të mira në krahasim me një vit më parë.

Plani i punës për vitin përkatës zhvillohet në bashkëpunim të plotë me komunën partnere, respektivisht me përgjegjësit e fushave të përkrahjes së projektit, ashtu që plani i punës pas finalizimit aprovohet zyrtarisht nga ana e kryetarit të komunës dhe kryesuesit të kuvendit të komunës.

Para hartimit të planit të punës, dokumentet dhe raportet e mëposhtme janë shqyrtuar:

- Raporti vjetor për vlerësimin e kapaciteteve në komunat në fokus, të realizuar nga këshilltarët komunalë të projektit të caktuar në secilën komunë,
- Anketa e perceptimit qytetar që realizohet nga TEAM i USAID për të gjitha komunat e Kosovës,

- Raporti i ZKA për komunat përkatëse,
- Raporti komunal i Gradimit,
- Raportet e ndryshme të OSHC, dhe
- Raporte dhe dokumente të institucioneve relevante për fushat e përkrahjes së projektit (Raportet e KRPP-së, vendimet e OSHP-së, raportet e Njësisë Qendrore të Harmonizimit (NJQH), raportet e MF/Thesarit, etj.).

Si rezultat i shqyrtimit të vlerësimeve, raporteve të ndryshme dhe arritjes së treguesve në vitin e caktuar, projekti USAID TEAM ndihmon komunën në zhvillimin e planit të punës për vitin vijues, i cili plan përmban disa elemente siç janë:

- Llojin/emërtimin e aktivitetit,
- Rezultatet e pritura nga ai aktivitet,
- Audiencën e synuar,
- Zyrtarin përgjegjës komunal për zbatim të aktivitetit, dhe
- Afatin kohor të zbatimit të planit të punës.

Mbështetjen të cilën do ta ofrojë USAID TEAM për realizimin e planit të punës janë të formës:

- Përkrahje në vendin e punës, takime, trajnime, punëtori - për arritjen e nivelit të gradimit dhe sigurimi i qëndrueshmërisë për nivelin e arritur,
- Monitorim i aktiviteteve për t'u siguruar konsistencën dhe qëndrueshmërinë e rezultateve të arritura,
- Asistencë në zhvillimin, ndërtimin dhe zbatimin e mekanizmave (procedura standarde të operimit - PSO, doracak-udhëzues, forma-shabllone, etj.) për të përmirësuar performancën, rritjen e përgjegjësive, llogaridhënies dhe transparencës në ofrimin e shërbimeve, të cilat sigurojnë vazhdimësi të aplikimit të proceseve-mekanizmave edhe pas përfundimit të projektit USAID TEAM, dhe
- Ndarja e përvojave dhe praktikave të mira në mes komunave – përmes takimeve brenda komunës por edhe tryezave dhe punëtorive të ndryshme në nivel vendi.

Bazuar në këtë angazhim, vlerësime vjetore dhe periodike apo edhe në nevojat e çastit (ad-hoc), projekti USAID TEAM, në bashkërendim me komunën partnere do të përditësojë planin e punës për të reflektuar në kohë reale ndryshimet apo nevojat e reja të komunës.

## PLANI I PUNËS SË KOMUNËS SË GJAKOVËS

Ky plan i punës do të shërbejë si udhëzues për periudhën që fillon në janar 2021 deri në Dhjetor 2021. Si i tillë, ai mëton të sigurojë arritjen e objektivave të përbashkëta të USAID TEAM dhe komunës së Gjakovës, të parapara për vitin 2021. Ky plan ka fokus të shtuar në përmirësimin e rezultateve në fushat në të cilat në bazë të rezultateve në raportin e gradimit për vitin 2020 niveli i arritjes nuk ka qenë i mjaftueshëm për të arritur shkallën e gradimit.

Plani i punës për vitin 2021 i komunës së Gjakovës bazohet në rezultatet e nxjerra nga këto raporte të vitit 2020:

- Raporti i Gradimit,
- Vlerësim vjetor i kapaciteteve të komunës,
- Raporti i perceptimit publik,
- Raporti i ZKA për pasqyrat financiare,
- Raportet e ndryshme të OSHC, dhe
- Raporte dhe dokumente tjera institucionale relevante për fushat e përkrahjes së projektit (raportet e KRPP-së, vendimet e OSHP-së, Raportet e NJQH, Raportet e MF/Thesarit, etj.).

Përkundër përmirësimeve dhe rezultateve të shumta gjatë këtyre katër viteve në komunën e Gjakovës, ka ende hapësirë për përmirësim me qëllim të arritjes së nivelit të gradimit të plotë si dhe mbajtjen e nivelit të gradimit.

Komuna e Gjakovës ka shënuar progres në vitin 2020 krahasuar me një vit më parë. Gjakova kishte vlerë fillestare prej 51 pikë në 2017, pastaj 64 pikë në 2018, 72 pikë në 2019 dhe 76 pikë në 2020. Sidoqoftë, komuna nuk i ka përmbushur kriteret e gradimit te arrij 80 pikë dhe gradën minimale prej gjashtë pikëve për secilin tregues individual. Në vitin 2020, komuna arriti rezultate pozitive dhe tejkaloi pragun minimal të gradimit për 8 nga 12 treguesit e gradimit:

- Ulje e përqindjes së aktiviteteve komunale të prokurimit të anuluara,
- Rritje e përqindjes së planit të prokurimit të zbatuar,
- Ulje e përqindjes së zbatimit të aktiviteteve të prokurimit që nuk janë planifikuar,
- Publikimi i dokumenteve dhe raporteve financiare, prokurimit dhe të auditimit,
- Rënie e përqindjes së perceptimit të qytetarëve për korrupsionin dhe transparencën në prokurimin publik dhe financa publike në nivel komunal për "perceptimin e pranisë së korrupsionit në shkallë të gjerë në komuna",
- Vlerësimi i kapacitetit të organizatës: Planifikimi dhe Buxhetimi,
- Vlerësimi i kapacitetit të organizatës: Kapaciteti i stafit, dhe
- Vlerësimi i kapaciteteve të organizatës: transparenca, etika, anti-korrupsioni dhe anti-mashtrimi.

Sidoqoftë, komuna ende nuk ka arritur të arrijë nivelin e gradimit edhe për 3 treguesit vijues, të cilët do të jenë në fokus edhe i zhvillimit të aktiviteteve të përbashkëta:

- Indeksi i ankesave në OSHP – Ulje e numrit te ankesave ne OSHP dhe rritja e numrit të vendimeve të OSHP-së në favor të Autoritetit Kontraktues,

- Indeksin e Efektivitetit të Menaxhimit të Kontratave Publike -aplikimi i dënimeve për vonesa në implementim të kontratave, ekzekutimi i pagesave (faturave të pranuara) brenda afatit ligjor, dhe numri i aneks kontratave
- Rritjen e përqindjes së zbatimit të rekomandimeve të ZKA-së në lidhje me menaxhimin e financave, prokurimin publik, zyrën e kryetarit të komunës, burimet njerëzore
- Rritje të përqindjes së zbatimit të rekomandimeve të auditimit të brendshëm (AB) në lidhje me menaxhimin e financave, prokurimin publik dhe burimet njerëzore (BNJ),

Asistenca e cila do të ofrohet për realizimin e planit të komunës së Gjakovës do të jetë:

- Përkrahje në vendin e punës, takime, trajnime, punëtori - për arritjen e nivelit të gradimit dhe sigurimi i qëndrueshmërisë për nivelin e arritur,
- Monitorim i aktiviteteve - për tu siguruar konsistencën dhe qëndrueshmërinë e rezultateve të arritura,
- Asistencë në zhvillimin, ndërtimin dhe zbatimin e mekanizmave (PSO, doracak-udhëzues, forma-shabllone, etj.) për të përmirësuar performancën, rritjen e përgjegjësive, llogaridhënies dhe transparencës në ofrimin e shërbimeve, të cilat sigurojnë vazhdimësi të aplikimit të proceseve-mekanizmave edhe pas përfundimit të projektit USAID TEAM, dhe
- Ndarja e përvojave dhe praktikave të mira në mes komunave – përmes takimeve brenda komunës por edhe tryezave dhe punëtorive të ndryshme në nivel vendi.

Bazuar në këtë angazhim, vlerësime vjetore dhe periodike apo edhe në nevojat e çastit (ad-hoc), projekti USAID TEAM, në bashkërendim me komunën e Gjakovës do ta përditësojë planin e punës për të reflektuar në kohë reale ndryshimet apo nevojat e reja të komunës.

Vlerësohet se mund të ketë ndryshime, devijime dhe shtojca në planin e punës për të adresuar nevojat specifike që mund të dalin në komunën e Gjakovës. Plani komunal diskutohet dhe dakordohet me udhëheqjen komunale dhe USAID TEAM. Për secilin aktivitet përcaktohet personi përgjegjës komunal dhe autorizohet që të jetë pikë e kontaktit me projektin USAID TEAM për Kryetarin e Komunës dhe/ose Kryesuesin e Kuvendit të komunës. Komuna e Gjakovës do ta zbatojë këtë plan të punës në mbështetje të projektit USAID TEAM. Plani i punës mund të adaptohet lehtë duke u plotësuar me aktivitete që përmirësojnë transparencën, efikasitetin dhe llogaridhënien, veçanërisht në fushën e prokurimit publik.

## ÇËSHTJE TJERA

Komuna do t'i ofrojë asistencë anëtarëve tjerë të stafit USAID TEAM dhe komunave tjera, duke shkëmbyer praktikat e suksesshme, mësimet e nxjerra, produktet dhe rezultatet e arritura në kuadër të projektit USAID TEAM. Kjo asistencë do të përfshijë, mes tjerash, këshillime, pjesëmarrjen në aktivitete, prezantimet, trajnimet e 'kolegëve për kolegët' etj.

## REZULTATET E PRITURA

Me realizimin e planit të punës 2021 priten të arrihen këto rezultate:

- Ngritja e kapaciteteve të zyrtarëve komunalë në tërë ciklin e prokurimit dhe zvogëlimi i cenueshmërisë ndaj korrupsionit përfshirë zhvillimin e specifikacioneve teknike dhe menaxhimin e kontratës,
- Forcimi i njësisë së auditimit të brendshëm (NJAB) dhe komitetit komunal të auditimit (KKA),
- Rritja e zbatimit të rekomandimeve të ZKA-së dhe AB,

- Rritja e transparencës në prokurim publik, auditimi dhe raportim financiar,
- Rritja e kapaciteteve komunale për menaxhim financiar, kontroll dhe llogaridhënie,
- Përmirësimi i perceptimit të banorëve të komunës për prokurimin publik, dhe
- Arritja e nivelit të qëndrueshëm të gradimit.

## 1.1 REALIZIMI I VLERËSIMIT VJETOR, ANKETËS DHE PLANIFIKIMI I AKTIVITETE

TEAM USAID e realizon një vlerësim vjetor të kapaciteteve të Komunës së Gjakovës në fushat e prokurimit publik, MFP, menaxhimit të kontratave publike, transparencën, BNJ dhe auditimin. Për më tepër, ajo realizon Anketë të Perceptimit Publik që përfshinë të gjitha 38 komunat e Kosovës. Gjetjet e nxjerra nga vlerësimi i kapacitetit të vitit paraprak, treguesit e gradimit (vjetor dhe periodik), Anketa e Perceptimit Publik, monitorimi i OJQ-ve, dhe mjetet tjera të vlerësimit, në bashkëpunim me udhëheqjen komunale dhe zyrtarët, janë përdorur për ta përshtatur dhe rafinuar përkrahjen teknike dhe për ta ngritur kapacitetin e komunës së Gjakovës.

### 1.1.1 PËRPILIMI I PLANIT TË PËRSHTATUR TË PUNËS PËR KOMUNËN E GJAKOVËS PËR VITIN 2021

Planet e përshtatura të punës e përshkruajnë kornizën kohore për arritjen e rezultateve, synimet e performancës që do të lidhen me arritjet e gradimit.

**Rezultatet e pritura:** Plani vjetor i punës i dakorduar dhe i a provuar nga Kryetari i Komunës dhe Kryesuesi i Kuvendit Komunal

**Audienca e synuar:** Përgjegjësit e drejtorive/njësive: prokurimit, financave, AB, BNJ, informimit, kabineti i kryetarit të komunës

**Afati kohor:** Shkurt 2021- Prill 2021

**Statusi përfundimtar:** Plani i punës i përpiluar dhe aprovuar nga kryetari dhe kryesuesi i kuvendit të komunës

**Personi përgjegjës në komunë:** Menaxheri i zyrës së prokurimit dhe shefi i kabinetit të kryetarit

### 1.1.2 VLERËSIMI I KAPACITETIT ORGANIZATIV TË KOMUNËS (VKOK) DHE MATJA E TREGUESVE TË GRADIMIT TË KOMUNËS - MONITORIMI I ZBATIMIT

**Rezultatet e pritura:**

- Vlerësimi i kapaciteteve organizative komunale dhe gradimi për 2020, analiza e të dhënave dhe raportimi
- Vlerësimi i rezultateve te gradimit dhe kapaciteteve organizative komunale për 2021
- Vlerësimi gjashtë mujor i treguesve të planit të gradimit.

**Audienca e synuar:** Përgjegjësit e drejtorive/njësive: prokurimit, financave, auditimit të brendshëm, burimeve njerëzore, informimit, kabineti i kryetarit të komunës, drejtoritë komunale

**Afati kohor:** Mars 2021 - Tetor 2021

**Statusi përfundimtar:** Janë përpiluar raportet e gradimit 2020 dhe 2021

**Personi përgjegjës në komunë:** Menaxheri i zyrës së prokurimit dhe shefi i kabinetit të kryetarit

### 1.1.3 NDARJA DHE DISKUTIMI I REZULTATEVE TË VLERËSIMIT TË KAPACITETEVE DHE TË REZULTATEVE TË GRADIMIT

**Rezultatet e pritura:** Organizimi i dy takimeve me komunën - takimi parë do të organizohet për ndarjen e rezultateve të gradimit për vitin 2020 me menaxhmentin e komunës, diskutim të çështjeve, rekomandimeve dhe adaptimeve të planit të punës. Takimi i dytë do të jetë një ngjarje e përbashkët me të 15 komunat në fokus, që do të zhvillohet në fund të vitit 2021, e këtu do të diskutohen rezultatet e gradimit për vitin 2021.

**Audienca e synuar:** Kryetari i komunës, kryesuesi i kuvendit, Përgjegjësit e drejtorive/njësive: prokurimit, financave, auditimit të brendshëm, burimeve njerëzore, zyra për informimit, kabineti i kryetarit të komunës, zyra ligjore, kryesuesi i komitetit të auditimit

**Afati kohor:** Prill 2021 dhe Nëntor 2021

**Statusi përfundimtar:** Organizimi i takimeve për diskutim të rezultateve të gradimit, i çështjeve, i rekomandimeve për përmirësim

**Personi përgjegjës në komunë:** Kryetar i komunës

## 1.2 MONITORIMI I KAPACITETEVE KOMUNALE NË PROKURIM DHE MENAXHIM TË PROJEKTEVE/KONTRATAVE

Bazuar në vlerësimet dhe raportet e ndryshme e posaçërisht në Raportin e Gradimit për komunën e Gjakovës për vitin 2020, vërehet se komuna ende nuk e ka arritur nivelin e gradimit edhe për katër tregues, të cilët në tërësi apo edhe pjesërisht, bien në kategorinë e aktiviteteve të prokurimit publik dhe menaxhimit të projekteve/kontratave, siç janë:

- Indeksi i ankesave në OSHP - Ulje e numrit te ankesave ne OSHP dhe rritja e numrit të vendimeve të OSHP-së në favor të Autoritetit Kontraktues
- Indeksi i Efektivitetit të Menaxhimit të Kontratave - aplikimi i dënimeve për vonesa në implementim të kontratave, ekzekutimi i pagesave (faturave të pranuara) brenda afatit ligjor,
- Rritja e përqindjes së zbatimit të rekomandimeve të ZKA-së në lidhje me prokurimin publik.
- Rritje të përqindjes së zbatimit të rekomandimeve të auditimit të brendshëm (AB) në lidhje me prokurimin publik

Komuna e Gjakovës arriti rezultate pozitive dhe e ka tejkaluar pragun minimal të gradimit për treguesit tjerë të cilët janë ose ndërlidhen me aktivitetet e prokurimit publik dhe atë:

- Ulje e përqindjes së aktiviteteve komunale të prokurimit të anuluara,
- Rritje e përqindjes së planit të prokurimit të zbatuar,
- Ulje e përqindjes së zbatimit të aktiviteteve të prokurimit që nuk janë planifikuar,
- Publikimi i dokumentacionit për aktivitetet e prokurimit.
- Rënie e përqindjes së perceptimit të qytetarëve për korrupsionin dhe transparencën në prokurimin publik dhe financa publike në nivel komunal për "perceptimin e pranisë së korrupsionit në shkallë të gjerë në komuna",
- Vlerësimi i kapacitetit të organizatës: Planifikimi dhe Buxhetimi,
- Vlerësimi i kapacitetit të organizatës: Kapaciteti i stafit, dhe
- Vlerësimi i kapacitetit të organizatës: Transparenca, etika, anti-korrupsioni dhe anti-mashtrimi.

Këshilltarët e projektit do të vazhdojnë të ofrojnë asistencë direkte dhe monitorim për zyrtarët e komunës së Gjakovës. USAID TEAM do të fokusohet në përforcimin e mekanizmave zbatuese dhe mbështetjen e intervenimeve të fokusuara për luftimin e korrupsionit në ciklin e prokurimit.

Me qëllim të rritjes së performancës së komunës së Gjakovës në proceset e prokurimit publik, si në arritjen e nivelit të gradimit ashtu edhe në qëndrueshmëri të rezultateve të arritura, gjatë vitit 2021 do të zhvillohen këto aktivitete:

### 1.2.1 PËRKRAHJE NË VEND TË PUNËS PËR AKTIVITETET KOMUNALE TË PROKURIMIT

Me qëllim të përmirësimit të performancës së komunës në treguesit e gradimit të fushës së prokurimit në të cilët komuna ka nivelin e performancën nën minimumin e pragut për gradim, projekti do të ofroj afrojë trajnime dhe asistencë në vendin e punës, në treguesit:

- Indeksi i ankesave në OSHP - Ulje e numrit te ankesave në OSHP dhe rritje e numrit të vendimeve të OSHP-së në favor të AK,
- Menaxhimi i kontratave - aplikimi i dënimeve për vonesa në implementim të kontratave, ekzekutimi i pagesave (faturave të pranuara) brenda afatit ligjor, dhe numri i aneks kontratave,
- Rritje të përqindjes zbatimit të rekomandimeve të ZKA lidhur me prokurim publik.
- Rritje të përqindjes së zbatimit të rekomandimeve të auditimit të brendshëm (AB) në lidhje me prokurimin publik

Këshilltari i prokurimit për komunën e Gjakovës do të ofrojë asistencë në vend pune për zyrtarët e prokurimit dhe zyrtarët e njësive të kërkesave të komunës në:

- Ngritje të kualitetit të hartimit të dosjeve të tenderit,
- Ndërtimi i kapacitetit në procesin e shqyrtimit të kërkesave të OE
- Ndërtimi i kapaciteteve në procesin e vlerësimit të ofertave
- Adresimi i rekomandimeve të ZKA dhe AB në fushën e prokurimit, dhe
- Në periudha të caktuara do të mbahen takime periodike me menaxherin e prokurimit si dhe me drejtorët e njësive kërkuese me qëllim të koordinimit më të mirë të aktiviteteve, të vlerësimit të progresit dhe identifikimit të nevojave për përmirësime përkatësisht për ndryshime.

**Rezultatet e pritura:** Ngritja e kapaciteteve të zyrtarëve të prokurimit, zyrtarëve të njësive të kërkesave si dhe përmirësimin e nivelit të performancës për treguesit e gradimit, siç janë:

- Ulje e numrit te ankesave në OSHP dhe rritje e numrit të vendimeve të OSHP-së në favor të AK
- Aplikimi i dënimeve për vonesat në implementim të projekteve.
- Rritja e përqindjes së zbatimit të rekomandimeve të ZKA-së dhe AB në prokurim publik,

**Audienca e synuar:** Zyrtarët e prokurimit, anëtarët e komisioneve të vlerësimit të tenderëve dhe zyrtarët e njësive kërkuese

**Afati kohor:** Janar 2021 - Dhjetor 2021

**Statusi përfundimtar:** Zbatimi ka përfunduar

**Personi përgjegjës në komunë:** Menaxheri i prokurimit dhe drejtorët/udhëheqësit e njësive kërkuese

### 1.2.2 MONITORIMI I AKTIVITETEVE TË PROKURIMIT

Edhe pse Komuna e Gjakovës tregoi një trend të qëndrueshëm të rezultateve duke arritur 76 pikë në 2020, komuna nuk e arriti pragun minimal të gradimit. Megjithatë, gjatë vitit 2021 Këshilltari i Prokurimit për komunën e Gjakovës do t'i monitorojë aktivitetet e prokurimit për treguesit që tani kanë vlera mbi pragun minimal të gradimit, siç janë:

- Ulje e përqindjes së aktiviteteve komunale të prokurimit të anuluara,
- Rritje e përqindjes së planit të prokurimit të zbatuar
- Ulje e përqindjes së zbatimit të aktiviteteve të prokurimit që nuk janë planifikuar,
- Publikimi i dokumentacionit për aktivitetet e prokurimit.
- Finalizimi i planit të prokurimit publik për vitin 2021 dhe hartimi i një plani fillestar të prokurimit për vitin 2022
- Përpilimi i Dosjes së Tenderit për aktivitetet e prokurimit
- Zbatoni aktivitetet e prokurimit publik për Vitin 2021 në përputhje me kornizën kohore në planin e prokurimit.
- Përdorimi i kriterit 'tenderi ekonomikisht më i favorshëm (TEMF)'.
- Përdorimi i kriterit për dhënie të kontratës sipas çmimit më të ulët.
- Përdorimi i aktivitetit të prokurimit duke e kufizuar numrin e lloteve.

Ndërsa zyrtarët komunal zhvillojnë aftësi në fusha specifike teknike, këshilltarët e prokurimit do të kalojnë në rol monitorues për ato fusha. Kurdoherë që këshilltarët prezantojnë aftësi ose proces të ri teknik, ata së pari do të ofrojnë më shumë përkrahje praktike të nivelit të transaksioneve, dhe pasi që aftësitë të transferohen, do të kalojnë në rol monitorues.

Pra, këshilltari i prokurimit për komunën e Gjakovës do të ofrojë asistencë përmes monitorimit në vend pune zyrtarët e prokurimit dhe zyrtarët e njësive të kërkesave të komunës në mbajtje apo edhe përmirësim të nivelit të gradimit për treguesit përkatës, si p.sh. në hartimit të dosjeve të tenderit, inicim të aktiviteteve të planifikuara sipas dinamikës së paraparë, anulim të aktiviteteve të prokurimit si dhe në inicim të aktiviteteve të pa planifikuara të prokurimit

**Rezultatet e pritura**: Qëndrueshmëria e ngritjes së deritanishme të kapaciteteve të zyrtarëve duke e mbajtur, përkatësisht përmirësuar rezultatet e treguesve të gradimit për të cilat pragu minimal i gradimit është arritur, siç janë:

- Ulje e përqindjes së aktiviteteve komunale të prokurimit të anuluara,
- Rritje e përqindjes së planit të prokurimit të zbatuar
- Ulje e përqindjes së zbatimit të aktiviteteve të prokurimit që nuk janë planifikuar,
- Publikimi i dokumentacionit për aktivitetet e prokurimit.
- Finalizimi i planit të prokurimit publik për vitin 2021 dhe hartimi i një plani fillestar të prokurimit për vitin 2022
- Përpilimi i Dosjes së Tenderit për aktivitetet e prokurimit
- Zbatoni aktivitetet e prokurimit publik për Vitin 2021 në përputhje me kornizën kohore në planin e prokurimit.

- Përdorimi i kriterit 'tenderi ekonomikisht më i favorshëm (TEMF)'.
- Përdorimi i kriterit për dhënie të kontratës sipas çmimit më të ulët.
- Përdorimi i aktivitetit të prokurimit duke e kufizuar numrin e lloteve.

**Audienca e synuar:** Zyrtarët e prokurimit, anëtarët e komisioneve të vlerësimit të tenderëve dhe zyrtarët e njësive kërkuese

**Afati kohor:** Janar 2021 - Dhjetor 2021

**Statusi përfundimtar:** Zbatimi ka përfunduar

**Personi përgjegjës në komunë:** Drejtori/menaxheri i prokurimit dhe menaxherët/drejtorët e njësive kërkuese

### 1.2.3 PËRKRAHJE NË VEND PUNE PËR MEKANIZMAT KOMUNALË NË PËRMIRËSIMIN E MENAXHIMIT TË PROJEKTIT DHE MENAXHIMIT TË KONTRATËS

Procesi i menaxhimit të projekteve dhe kontratave publike është vlerësuar si një çështje mjaft komplekse dhe sfiduese për komunat, duke përfshirë edhe komunën e Gjakovës ku treguesit e gradimit të cilët ndërlidhen me këtë çështje janë nën nivelin minimal të gradimit:

- Indeksi i ankesave në OSHP, përkatësisht numri i vendimeve në favor të OE i cili është si pasojë e hartimit të dobët të projekteve (specifikacioneve teknike),
- Indeksin e Efektivitetit të Menaxhimit të Kontratave Publike (ekzekutimi i kontratave sipas dinamikës së paraparë, aplikimi i dënimeve për vonesa në implementim të kontratave), dhe
- Rritjen e përqindjes së zbatimit të rekomandimeve të ZKA-së dhe NJAB në lidhje me menaxhimin e kontratave publike dhe kualitetit të specifikacioneve teknike.

Për ta përmirësuar performancën e komunës në treguesit e gradimit në lidhje me proceset e menaxhimit të projektit dhe menaxhimin e kontratave publike, projekti i USAID TEAM do të jep asistencë të drejtpërdrejtë në vend të punës dhe trajnim përmes aktiviteteve të mëposhtme:

- Asistenca në vendin e punës në hartimin e specifikacioneve teknike, menaxhimin e kontratave, administrimin e dokumentacionit adekuat në procesin e menaxhimit të kontratës dhe kontrollit të cilësisë,
- Zbatimi i rekomandimeve të ZKA dhe NjAB në fushën e menaxhimit të kontratës-projektit, aplikimin e dënimeve, anekset e kontratave, etj.,
- Në periudha të caktuara do të mbahen takime periodike me menaxherin e prokurimit si dhe me drejtorët e njësive kërkuese, dhe nëse kërkohet edhe me Kryetarin e Komunës, me qëllim të koordinimit më të mirë të aktiviteteve, të vlerësimit të progresit dhe identifikimit të nevojave për përmirësime përkatësisht për ndryshime.

**Rezultatet e pritura:** Rritja e kapaciteteve të zyrtarëve të njësive kërkuese dhe menaxherëve të kontratave në procesin e menaxhimit të projektit publik dhe menaxhimit të kontratave. Përveç kësaj, përmirësimi i nivelit të performancës për treguesit e gradimit, siç janë:

- Indeksi i Menaxhimit të Kontratave (aplikimi i dënimeve për vonesat në zbatimin e projektit; zvogëlimi i numrit të aneks kontratave, ekzekutimi i pagesave (faturave të pranuara) brenda afatit ligjor);

- Rritja e përqindjes së zbatimit të rekomandimeve të ZKA-së dhe NJAB në menaxhim të kontratave, hartimi i specifikacioneve teknike, etj.,

**Audienca e synuar:** Zyrtarët komunalë nga njësitë e kërkesave, menaxherët e kontratave dhe zyra e prokurimit

**Afati kohor:** Janar 2021 - Dhjetor 2021

**Statusi përfundimtar:** Zbatimi ka përfunduar

**Personi përgjegjës në komunë:** Kryetari i komunës dhe menaxheri i prokurimit

### 1.2.4 SHPËRNDARJA E PRAKTIKAVE DHE PROCESEVE TË PROKURIMIT PUBLIK

Një nga aktivitetet e rregullta në procesin e shkëmbimit të praktikave më të mira është organizimi i tryezave të kolegjiumit të prokurimeve publike të AKK-së, me qëllim të shkëmbimit të përvojave ndërmjet menaxherëve të prokurimit të të gjitha komunave të Kosovës dhe këshilltarëve të USAID për prokurimin publik të TEAM, për të diskutuar sfidat komunale me institucionet përkatëse të nivelit qendror (KRPP, PRB, AQP), dhe për të dhënë rekomandime se si të adresohen ato sfida.

Gjithashtu, do të organizohet një tryezë për të ndarë praktika të mira të vendeve të regjionit në proces të menaxhimit të projekteve dhe kontratave publike.

**Rezultatet e pritura:** Organizimi dhe mbajtja e dy tryezave të Kolegjiumit të prokurimit publik të AKK,

**Audienca e synuar:** Menaxherët e prokurimit dhe menaxherët e zyrave të investimeve publike

**Afati kohor:** Prill 2021 dhe Shtator 2021

**Statusi përfundimtar:** Shpërndarja e praktikave

**Personi përgjegjës në komunë:** Menaxheri i prokurimit

## 1.3 RRITJA E KAPACITETIT TË NJËSISË KOMUNALE TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM (NJAB) DHE KOMITETIT KOMUNAL TË AUDITIMIT (KKA)

Bazuar në vlerësimet dhe raportet e ndryshme e posaçërisht edhe në Raportin e Gradimit për komunën e Gjakovës për vitin 2020, vërehet se komuna në vitin 2020 ende nuk ka arritur nivelin e gradimit edhe për tre treguesit tjerë, një nga të cilët bie në kategorinë e auditimit dhe atë:

- Rritja e përqindjes së zbatimit të rekomandimeve të ZKA-së.
- Rritja e përqindjes në zbatimin e rekomandimeve të NjAB-së.

Projekti USAID TEAM do të vazhdojë të ofrojë asistencë në vendin e punës, monitorim por edhe ndërtim të mekanizmave ashtu që të kemi rritje të performancës në fushën e auditimit, në proceset e rritjes së kontrollit dhe llogaridhënies, dhe në performancë gjatë procesit të gradimit. Për më tepër, ai do ta fuqizojë NjAB-në, Komitetin Komunal të Auditimit (KKA), dhe do t'i rrisë kapacitetet e Komisionit të Financave dhe Politikave.

USAID TEAM do të fokusohet në përforcimin e mekanizmave zbatues dhe përkrahjen e intervenimeve të fokusuara për luftimin e korrupsionit në ciklin e prokurimit Për këtë gjatë vitit 2021 në fushën e auditimit do të zhvillohen këto aktivitete:

### 1.3.1 PËRKRAHJE NË VEND PUNE NË FUSHËN E AUDITIMIT.

Me qëllim të përmirësimit të performancës së komunës në treguesit e gradimit në të cilët komuna ka nivelin e performancën nën minimumin e pragut për gradim, projekti do të ofrojë trajnime dhe asistencë në vendin e punës, kurse për treguesit për të cilët komuna ka performancë të mirë dhe është mbi pragun e gradimit,

do të bëhet monitorim i aktiviteteve me qëllim të mbajtjes dhe rritjes së nivelit të performancës për këta tregues, me fokus në fuqizimin e NJAB dhe KKA si dhe në adresimin e rekomandimeve të pranuara nga auditorët. Në këtë drejtim zbatimi i rekomandimeve të NJAB mbetet synim i projektit posaçërisht në fushat me prioritet për projektin: Financa, Prokurim, Auditim të Brendshëm dhe Burime Njerëzore

Aktivitetet të cilat do të zhvillohen përmes asistencës në vend pune do të jenë:

- Përkrahje e menaxhmentit komunal për të forcuar Njësinë e Auditimit të Brendshëm dhe Komitetin Komunal të Auditimit,
- Diskutimi dhe ofrimi i komenteve në raportin e ZKA-së,
- Përpilimi i Planit të Veprimit në zbatimin e rekomandimeve të ZKA-së,
- Asistencë direkte për njësitë komunale për zbatimin e rekomandimeve të ZKA,
- Asistencë direkte njësive komunale në zbatim të rekomandimeve të NJAB,
- Asistencë direkte menaxhmentit të komunës për vlerësimin periodik rreth zbatimit të rekomandimeve të ZKA-së dhe NJAB,
- Rritja e cilësisë së raporteve të auditimit të brendshëmMonitorimi dhe përmirësimi i cilësisë së Planit të Veprimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm

**Rezultatet e pritura:**

- Cilësia e përmirësuar e Planeve të Veprimit të NjAB dhe vetëvlerësimit të performancës së KKA
- Rritja e nivelit të zbatimit të rekomandimeve të ZKA-së dhe NJAB;
- Mbajtja e takimeve periodike për vlerësimin e zbatimit të rekomandimeve,

**Audienca e synuar:** Menaxhmenti i komunës, NJAB, KKA, drejtoritë/njësite komunale të cilat kanë rekomandime nga ZKA, NJAB dhe KPF

**Afati kohor:** Janar 2021 - Tetor, 2021

**Statusi përfundimtar:** Rritja e nivelit të zbatimit të rekomandimeve të ZKA-së dhe NJAB

**Personi përgjegjës në komunë:** Udhëheqësi i NJAB-së dhe kryesuesi i komitetit

### 1.3.2 MONITORIM NË AKTIVITETET E AUDITIMIT

Me qëllim të sigurimit të qëndrueshmërisë dhe përmirësimit të mëtutjeshëm të rezultateve të arritura në fushën e auditimit, projekti USAID TEAM përmes ekspertëve të vet të auditimit, do ta monitorojë një numër të aktiviteteve të fushës së auditimit, siç janë:

- Përpilimi i Planit të Veprimit nga njësitë komunale të audituara për t'i adresuar rekomandimet e NjAB-së,
- Hartimi i planit vjetor të NJAB,
- Realizimi i planit vjetor të NJAB,
- Publikimi i raportit të ZKA-së në uebfaqen e komunës, dhe
- Organizimi i aktiviteteve dhe takimeve të Komitetit Komunal të Auditimit.

**Rezultatet e pritura:** Fuqizimi i NJAB dhe KKA

**Audienca e synuar:** Menaxhmenti i komunës, NJAB, KKA, drejtoritë/njësitë komunale të cilat kanë rekomandime nga ZKA, NJAB dhe KPF

**Afati kohor:** Janar 2021 - Tetor, 2021

**Statusi përfundimtar:** Niveli i rritur i zbatimit të planit të punës së Njësisë së Auditimit të Brendshëm dhe niveli i rritur të zbatimit të rekomandimeve të auditimit

**Personi përgjegjës në komunë:** Udhëheqësi i NJAB-së dhe Kryesuesi i Komitetit të Auditimit

### 1.3.3. SHPËRNDARJA E PRAKTIKAVE DHE PROCESEVE PËR TË ZHVILLUAR KAPACITETET E NJAB DHE KKA

Një nga aktivitetet e rregullta në procesin e shkëmbimit të praktikave më të mira është organizimi i tryezave të drejtuesve komunalë të njësive të auditimit të brendshëm me qëllim të shkëmbimit të përvojave ndërmjet tyre dhe Këshilltarëve të Auditimit të TEAM USAID. Gjatë këtyre tryezave, diskutohen sfidat me institucionet përkatëse (NjQH dhe ZKA) dhe prodhohen rekomandime për të adresuar ato sfida.

**Rezultatet e pritura:** Organizimi i dy tryezave për ndarje të praktikave dhe proceseve në ngritje të kapaciteteve të NJAB dhe KKA

**Audienca e synuar:** Udhëheqësit Komunal të Njësive të Auditimit të Brendshëm dhe Kryesuesit e Komiteteve Komunale të Auditimit

**Afati kohor:** Maj 2021 - Shtator 2021

**Statusi përfundimtar:** Zbatimi ka përfunduar

**Personi përgjegjës në komunë:** Udhëheqësi i NJAB-së dhe Kryesuesi i Komitetit të Auditimit

## 1.4 PËRKRAHJA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE KOMUNALE

Në kuadër të procesit të përkrahjes dhe monitorimit, USAID TEAM ne fushën e burimeve njerëzore do bashkëpunojë aktivisht me komunën për të përforcuar segmentin e etikës si dhe luftimin e nepotizmit dhe korrupsionit nëpërmjet rritjes se aplikimit të SIMBNJ, ekzekutimit të kodit mirësjelljes/etikës. Qasja e projekti do te jetë e fokusuar ne fushat ne vijim:

- Përkrahja e njësisë së BNJ,
- Monitorim të instrumenteve dhe mekanizmave te ciklet e më hershme të projektit, dhe
- Shpërndarja e praktikave të mira në menaxhimin e BNJ.

### 1.4.1 MONITORIMI I AKTIVITETEVE NË MENAXHIM TË BNJ DHE IMPLEMENTIM TË KODIT TË ETIKËS, INSTRUMENTEVE, MEKANIZMAVE NGA CIKLET E ME HERSHME TE PROJEKTIT.

Pas përpilimit të kodit të etikës për komunën e Gjakovës, me asistencën e projektit USAID TEAM, projekti do ta realizojë monitorimin e zbatimit të këtyre dokumenteve. Në kuadër të këtij aktiviteti projekti do ta monitorojë zbatimin e:

- Kodit të etikës

**Rezultatet e pritura:** Implementimi i Kodit të Etikës dhe Planit të Integritetit

**Audienca e synuar**: Zyrtarët e BNJ

**Afati kohor:** Janar 2021 - Tetor, 2021

**Statusi përfundimtar:** Instrumentet dhe mekanizmat e BNJ shfrytëzohen nga shumica e personelit të komunës

**Personi përgjegjës në komunë:** Udhëheqësi i BNJ

### 1.4.2 SHPËRNDARJA E PRAKTIKAVE DHE PROCESEVE TË MIRA NË MENAXHIMIN E BURIMEVE NJERËZORE.

Në bashkëpunim me MAPL, MPB, NjQH dhe Asociacionin e Komunave të Kosovës (AKK), TEAM i USAID-it do të punojë me të gjithë menaxherët komunalë të BNj për t'i ndarë praktikat më të mira të fituara gjatë katër viteve të fundit, sfidat në BNJ, zbatimin e rekomandimit të ZKA në fushën e BNJ, do të zhvillojë video-trajnime për SMIBNJ etj.

Projekti do të organizojë një tryezë të rrumbullakët ku do të ndahen përvojat dhe proceset në menaxhimin e BNJ, integritetit dhe etikës me menaxherët e zyrave komunale të burimeve njerëzore të të gjitha komunave të Kosovës.

**Rezultatet e pritura:** Projekti do ta organizojë një tryezë për shkëmbimin e përvojave dhe praktikave të mira në menaxhimin e burimeve njerëzore me menaxherët e burimeve njerëzore të të gjitha komunave të Kosovës dhe me zyrtarë të MPL.

**Audienca e synuar:** Menaxherët e zyrave komunale të BNJ

**Afati kohor:** Maj 2021.

**Statusi përfundimtar:** Ndarja e përvojave në fushën e BNJ është realizuar me sukses

**Personi përgjegjës në komunë:** Udhëheqësi i zyrës së BNJ në komunë

## 1.5 RRITJA E TRANSPARENCËS KOMUNALE

Në vitin 2020 Komuna e Gjakovës ka arritur rezultate të dukshme në treguesin e transparencës. Komuna është vlerësuar me 7.8 pikë nga projekti TEAM i USAID për sasinë dhe cilësinë e informacionit të ofruar për publikun përmes mjeteve të informimit. Komuna i ka publikuar me sukses të gjitha dokumentet zyrtare dhe raportet në faqen e saj zyrtare. Dokumentet e mëposhtme japin informata detaje për publikimin e dokumenteve zyrtare brenda treguesit të transparencës në planin e gradimit, i cili do të publikohet rregullisht në uebsajtin e komunës,

- Publikimi i Planit të Prokurimit,
- Publikimi i informatave të aktiviteteve të prokurimit,
- Publikimi i të dhënave për seri kohore mujore për të hyrat dhe shpenzimet komunale,
- Korniza Afatmesme Buxhetore,
- Buxheti i miratuar,
- Raportet periodike financiare, (muajt 3, 6 dhe 9)
- Raporti vjetor financiar,
- Raporti i ZKA-së,
- Plani Vjetor komunal, dhe
- Raporti gjashtëmujor i kryetarit të komunës, dhe
- Raport vjetor i Kryetarit të Komunës.

TEAM USAID do të vazhdojë ta monitorojë komunën në përdorimin e sistemeve qeveritare për ta publikuar dokumentacionin dhe informatat nga prokurimi, auditimi dhe fusha e financave. Pavarësisht nga suksesi i saj, komuna duhet të vazhdojë me trendin pozitiv të publikimit të dokumenteve dhe raporteve

në uebsajtin zyrtar për të gjitha aktivitetet të cilat janë gjithashtu lehtësisht të arritshme nga të gjithë hisedarët e interesuar.

### 1.5.1 MONITORIMI I AKTIVITETEVE TË TRANSPARENCËS KOMUNALE

Duke u bazuar ne performancën e mirë të komunës në fushën e transparencës komunale, USAID TEAM do të monitorojë aktivitetet për publikimin e dokumenteve nga prokurimi, financa, zyra për informim publik si dhe në implementimin e strategjisë dhe planit komunal për komunikim publik. Gjithashtu projekti në bashkëpunimin me komunën do të angazhohet në avancim të mëtutjeshëm të transparencës komunale.

**Rezultatet e pritura:**

- Publikimi i rregullt i dokumenteve dhe raporteve në uebsajtin e komunës nga fushat e financave (korniza buxhetore afatmesme komunale KBAK, buxheti, raportet/rishikimet vjetore, mujore, tremujore dhe vjetore),
- Raporti i ZKA-së,
- Prokurimi (Plani i Prokurimit, kontratat e prokurimit dhe dokumentet tjera të prokurimit publik), Plani i Punës së Zyrës së Kryetarit dhe raportet periodike dhe vjetore).

**Audienca e synuar:** Zyrtarët për informim publik, zyrtarët e prokurimit, zyrtarët e IT-së, shefi i kabinetit të kryetarit, sekretaria e kuvendit, zyrtarët kryesorë financiar (ZKF), drejtori i financave

**Afati kohor:** Janar 2021 - Tetor, 2021

**Statusi përfundimtar:** Publikimi i rregullt i dokumenteve dhe implementimi i strategjisë për komunikim

**Personi përgjegjës në komunë:** Udhëheqësi i zyrës për informim

### 1.5.2 ZBATIMI I STRATEGJISË KOMUNALE PËR KOMUNIKIM

Strategjia i përkrahë komunikimet e strukturuara, në mënyrë që mekanizmat e komunikimit të jenë efikas, të përshtatshëm dhe të qëndrueshëm dhe si të tillë e përkrahin përmbushjen e misionit të komunës. Këto strategji synojnë të përmirësojnë dhe avancojnë mekanizmat e saj të komunikimit me audienca të shumta në mënyrë që t'i përgjigjen dinamikës së re teknike dhe teknologjike dhe nevojave dhe kërkesave të qytetarëve për shërbime cilësore dhe informacion të saktë dhe në kohë. Në proceset e vlerësimit të transparencës komunale, një sfidë e evidentuar si nga projekti ashtu edhe nga raportet e ndryshme të OJQ-ve dhe MPL, është se nuk ka standard për publikim të informatave dhe dokumenteve komunale. Për këtë me qëllim të standardizimit të publikimit të informatave, dokumenteve/akteve komunale dhe me qëllim të sigurimit të qëndrueshmërisë në procese të publikimit të tyre, projekti USAID TEAM së bashku me MPL dhe komunat në fokus e përpiluan një PSO udhëzuese për t'i standardizuar publikimet në uebfaqet e komunës. Kjo PSO dhe këto modele pritet të finalizohen në prill, pas diskutimit me zyrtarët komunalë të informimit dhe do të ndahen me të gjitha komunat e Kosovës.

**Rezultatet e pritura:**

- Implementimi i strategjisë për komunikim

**Audienca e synuar:** Zyra komunale për informim dhe grupi punues

**Afati kohor:** Janar 2021 - Tetor, 2021

**Statusi përfundimtar:** Procedurat Standarde Operative janë aprovuar.

**Personi përgjegjës në komunë:** Udhëheqësi i zyrës komunale për informim

- Indeksin e Efektivitetit të Menaxhimit të Kontratave Publike - ekzekutimi i pagesave për faturat e pranuara brenda afatit ligjor,
- Rritjen e përqindjes së zbatimit të rekomandimeve të ZKA-së në lidhje me financat publike, dhe
- Rritjen e përqindjes së zbatimit të rekomandimeve të auditimit të brendshëm në lidhje me financat publike.

Projekti do të ofrojë asistencë në vend pune për zyrtarët financiar dhe zyrtarët e njësive të kërkesave të komunës, në ngritje të kualitetit të kontrollit dhe menaxhimit të financave publike. Pra, do të jepet asistencë direkte në zbatimin praktik të PSO-së për ekzekutimin e faturave brenda afatit ligjor, si dhe në adresimin e rekomandimeve të fushës së kontrollit dhe menaxhimit të financave publike të ZKA dhe NJAB. Në periudha të caktuara do të mbahen takime periodike me ZKF, drejtorin e financave dhe drejtorët e njësive kërkuese me qëllim të koordinimit të aktiviteteve në vlerësimin e adresimit të zbatimit të rekomandimeve të ZKA dhe NJAB, si dhe identifikimit të nevojave për ndryshime. Ekipin komunal të involvuar në procesin e zhvillimit gjithëpërfshirës të buxhetit komunal ashtu që të arrihet realizim sa më i madh i buxhetit të planifikuar, përkatësisht të aktiviteteve të planifikuara të prokurimit si dhe numër sa më i vogël i inicimit të aktiviteteve të pa planifikuara,

**Rezultatet e pritura:**

- Implementimi i planit te prokurimit sipas planifikimit buxhetor
- Rritja e përqindjes së ekzekutimit të pagesave brenda afatit ligjor, dhe
- Rritja e përqindjes së adresimit të rekomandimeve financiare të ZKA dhe NJAB.

**Audienca e synuar**: Drejtoria e financave dhe të gjitha njësitë e kërkesave në komunë

**Afati kohor:** Janar 2021 – Dhjetor 2021

**Statusi përfundimtar:** PSO e pagesave zbatohet nga ana e komunës

**Personi përgjegjës në komunë:** Drejtori i financave dhe ZKF

### 1.6.2 MONITORIMI I AKTIVITETEVE PËR PROCESET E MENAXHIMIT TË FINANCAVE PUBLIKE

Meqenëse komuna e Gjakovës e ka arritur dhe tejkaluar pragun minimal të gradimit në një numër të treguesve, gjatë vitit 2021 Këshilltari i MFP do t'i jep komunës përkrahje për aktivitetet e MFP për treguesit e mëposhtëm:

- Zbatimi i planifikimit gjithëpërfshirës të buxhetit,
- Rritje e përqindjes se zbatimit te rekomandimeve te ZKA dhe NJAB ne fushën e financave

Pra, këshilltari i financave do të jep asistencë duke monitoruar në vend pune:

- Ekipin komunal në plotësimin e pyetësorit vetë-vlerësues,
- Zbatimi i mekanizmave të zhvilluar financiarë: Libri i proceseve, manualeve/PSO-ve
- Drejtorive komunale ne kompletimin e modeleve (mostrave) për planifikim buxhetor

**Rezultatet e pritura:**

- Pyetësori i plotësuar i vetëvlerësimit
- Zbatimi i mekanizmave të zhvilluar financiarë: Libri i proceseve, manualeve/PSO-ve
- Buxheti komunal i zhvilluar për vitin 2022.

**Audienca e synuar:** Drejtoria e financave, të gjitha drejtoritë dhe zyrat e komunës

**Afati kohor:** Janar 2021 – Dhjetor 2021

**Statusi përfundimtar:** Buxheti vjetor i aprovuar, dhe pyetësori vetë-vlerësues i dorëzuar brenda afatit

**Personi përgjegjës në komunë:** Drejtori i financave dhe ZKF

### 1.6.3 PËRKRAHJE NË ZHVILLIMIN, NDËRTIMIN DHE ZBATIMIN E MEKANIZMAVE (PSO, DORACAK-MANUAL, FORMA-SHABLLONE, ETJ.) FINANCIARE

Projekti në kuadër të bashkëpunimit me komunën, ka planifikuar ta realizojë një varg instrumentesh dhe mekanizmash rregullativ financiar Projekti në koordinim dhe bashkëpunim me partnerët (komunat, MF dhe NJQH) do të zhvillojë disa PSO për procese nga fusha e financave publike:

- PSO për të hyrat komunale është zbatuar
- PSO për pasuritë komunale jo-financiare është zbatuar

**Rezultatet e pritura:** PSO të zhvilluara

**Audienca e synuar:** Drejtori i financave, ZKF dhe grupi punuesve

**Afati kohor:** Janar 2021 – Dhjetor 2021

**Statusi përfundimtar:** PSO të zhvilluara

**Personi përgjegjës në komunë:** Drejtori i financave dhe ZKF

### 1.6.4 SHPËRNDARJA E PRAKTIKAVE TË MIRA PËR MENAXHIMIN DHE KONTROLLIN FINANCIAR

Një aktivitet i rregullt për shkëmbimin e praktikave më të mira është organizimi i tryezave të rrumbullakëta ndërmjet drejtorëve të financave, ZKF-ve nga të gjitha komunat e Kosovës dhe projekti USAID TEAM. Për më tepër, diskutimi i sfidave të komunave me institucionet përkatëse të nivelit qendror (MF, MPL, AKK) dhe hartimi i rekomandimeve për t'i adresuar ato sfida.

**Rezultatet e pritura:** Dy tryeza me qëllim të ndarjes së përvojave në ZKF dhe kontrollit

**Audienca e synuar:** Drejtorët komunal të financave dhe ZKF-të

**Afati kohor:** Prill 2021 – Shtator 2021

**Statusi përfundimtar:** Zbatimi ka përfunduar

**Personi përgjegjës në komunë:** Drejtori i financave dhe ZKF

Gjakovë, më 08.06. 2021

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVA
Komuna e Gjakovës • Opština Đakovica • Municipality Gjakova
Kuvendi i Komunës
01

Kryetari i Komunës së Gjakovës

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

**Aneksi I: Zhvillimi, Rafinimi dhe Futja në Përdorim e Modeleve për Komuna Transparente dhe Llogaridhënëse**

| HAPAT KRYESOR TË VEPRIMIT | AFATI KOHOR | PERSONI PËRGJEGJËS | AUDIENCA E SYNUAR | REZULTATET E PRITURA | BURIMI I TË DHËNAVE DHE METODOLOGJIA E VLERËSIMIT |
|---|---|---|---|---|---|
| 1.1. REALIZIMI I VLERËSIMIT VJETOR, ANKETËS DHE PLANIFIKIMI I AKTIVITETE | | | | | |
| 1.1.1 Përpilimi i planit të përshtatur të punës për komunën e Gjakovës për vitin 2021 | Shkurt 2021- prill 2021 | **Komuna:** Menaxheri i zyrës së prokurimit dhe shefi i kabinetit të kryetarit<br>**USAID TEAM:** Shefi/zëvendësshefi i projektit | Përgjegjësit e drejtorive/njësive: prokurimit, financave, AB, BNJ, informimit, kabineti i kryetarit të komunës | Plani i punës i zhvilluar dhe aprovuar nga kryetari dhe kryesuesi i kuvendit të komunës | Raporti i Vlerësimit të Kapaciteteve, Raporti i Gradimit<br>Raporti i ZKA-së, etj. |
| 1.1.2 Vlerësimi i kapacitetit organizativ të komunës (VKOK) dhe matja e treguesve të gradimit të komunës - monitorimi i zbatimit | Mars 2021 - tetor 2021 | **Komuna:** Menaxheri i zyrës së prokurimit dhe shefi i kabinetit të kryetarit<br>**USAID TEAM:** C1, NjKA | Udhëheqësit e drejtorive/njësive: prokurimit, financave, AB, BNJ, informimit, kabineti i kryetarit të komunës, drejtoritë komunale | Vlerësimi i kapacitetit komunal organizativ dhe për gradim për analizën e të dhënave 2020 dhe për raportim<br>Rezultatet e vlerësimit të kapaciteteve komunale organizative dhe për gradim për 2021 | E-Prokurimi, uebsajtet e Komunave, Thesari |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Vlerësimi gjashtë mujor i treguesve të planit të gradimit. | |
| 1.1.3 Ndarja dhe diskutimi i rezultateve të vlerësimit të kapaciteteve dhe të rezultateve të gradimit | Prill 2021 dhe nëntor 2021 | **Komuna:** Kryetar i komunës<br>USAID TEAM: Shefi/zëvendësshefi i projektit | Kryetari i komunës, kryesuesi i kuvendit, përgjegjësit e drejtorive/njësive: prokurimit, financave, AB, BNJ, zyra për informimit, kabineti i kryetarit të komunës, zyra ligjore, kryesuesi i komitetit të auditimit | Organizimi i dy takimeve me komunën - takimi parë do të organizohet për ndarjen e rezultateve të gradimit për vitin 2020 me menaxhmentin e komunës, diskutim të çështjeve, rekomandimeve dhe adaptimeve të planit të punës. Takimi i dytë do të jetë një ngjarje e përbashkët me të 15 komunat në fokus, që do të zhvillohet në fund të vitit 2021, e këtu do të diskutohen rezultatet e gradimit për vitin 2021. | Raporti i gradimit |
| 1.2 PËRMIRËSIMI I KAPACITETEVE KOMUNALE PËR CIKLIN E PROKURIMIT | | | | | |
| 1.2.1 Mbështetje në vend pune për aktivitetet komunale të prokurimit | Janar 2021 - Dhjetor 2021 | **Komuna**: Drejtori i prokurimit dhe drejtorët/udhëheqësit e njësive kërkuese<br>**USAID TEAM:** C1, NjKA | Zyrtarët e prokurimit, anëtarët e komisioneve të vlerësimit të tenderëve dhe zyrtarët e njësive kërkuese | Ulje e numrit te ankesave në OSHP dhe rritje e numrit të vendimeve të OSHP-së në favor të AK<br>Aplikimi i dënimeve për vonesat në implementim të projekteve.<br>Rritja e përqindjes së zbatimit të rekomandimeve të ZKA-së | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | dhe AB në prokurim publik | |
| 1.2.2 Monitorim i aktiviteteve të prokurimit | Janar 2021 - Dhjetor 2021 | **Komuna**: Drejtori/menaxheri i prokurimit dhe menaxherët/drejtorët e njësive kërkuese<br>**USAID TEAM:** C1, NjKA | Zyrtarët e prokurimit, anëtarët e komisioneve të vlerësimit të tenderëve dhe zyrtarët e njësive kërkuese | Ulje e përqindjes së aktiviteteve komunale të prokurimit të anuluara,<br>Rritje e përqindjes së planit të prokurimit të zbatuar<br>Ulje e përqindjes së zbatimit të aktiviteteve të prokurimit që nuk janë planifikuar,<br>Publikimi i dokumentacionit për aktivitetet e prokurimit.<br>Finalizimi i planit të prokurimit publik për vitin 2021 dhe hartimi i një plani fillestar të prokurimit për vitin 2022<br>Përpilimi i Dosjes së Tenderit për aktivitetet e prokurimit<br>Zbatoni aktivitetet e prokurimit publik për Vitin 2021 në përputhje me kornizën kohore në planin e prokurimit.<br>Përdorimi i kriterit 'tenderi ekonomikisht më i favorshëm (TEMF)'.<br>Përdorimi i kriterit për dhënie të kontratës sipas çmimit më të ulët.<br>Përdorimi i aktivitetit të prokurimit duke e kufizuar numrin e lloteve. | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | |
| 1.2.3 Përkrahje në vend pune për mekanizmat komunalë në përmirësimin e menaxhimit të projektit dhe menaxhimit të kontratës | Janar 2021 - Dhjetor 2021 | **Komuna**: Kryetari i komunës dhe menaxheri i prokurimit<br>USAID TEAM: Shefi/zëvendësshefi i projektit, CI, NjKA | Zyrtarët komunalë nga njësitë e kërkesave, menaxherët e kontratave dhe zyra e prokurimit | Indeksi i Menaxhimit të Kontratave (rritja e % të zbatimit të kontratës sipas afatit të kontraktuar; aplikimi i dënimeve për vonesat në zbatimin e projektit; zvogëlimi i numrit të aneks kontratave, ekzekutimi i pagesave (faturave të pranuara) brenda afatit ligjor);<br>Rritja e përqindjes së zbatimit të rekomandimeve të ZKA-së dhe NJAB në menaxhim të kontratave, hartimi i specifikacioneve teknike, etj., dhe<br>Përkrahja e komunës së Gjakovës në themelimin e zyrës së projekteve. | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 1.2.5 Shpërndarja e praktikave dhe proceseve të prokurimit publik | Prill 2021 dhe shtator 2021 | **Komuna**: Menaxheri i prokurimit<br>USAID TEAM: Shefi/zëvendësshefi i projektit, CI, NjKA | Menaxherët e prokurimit dhe menaxherët e zyrave të investimeve publike | Dy tryeza të mbajtura me Kolegjiumin e prokurimit të AKK;<br>Punëtori e mbajtur për praktika të mira të shteteve të regjionit në proces të menaxhimit të projekteve dhe kontratave publike. | Të dhënat e programit, lista e pjesëmarrjes |
| 1.3 RRITJA E KAPACITETIT TË NJËSISË KOMUNALE TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM (NJAB) DHE KOMITETIT KOMUNAL TË AUDITIMIT (KKA) | | | | | |
| 1.3.1 Përkrahje në vend pune në fushën e auditimit. | Janar 2021 - tetor, 2021 | **Komuna:** Udhëheqësi i NJAB-së dhe kryesuesi i komitetit të auditimit<br>USAID TEAM: C1, NjKA | Menaxhmenti i komunës, NJAB, KKA, drejtoritë/njësit komunale të cilat kanë rekomandime nga ZKA, NJAB dhe anëtarët e KPF. | Cilësia e përmirësuar e Planeve të Veprimit të NjAB dhe vetëvlerësimit të performancës së KKA<br>Rritja e nivelit të zbatimit të rekomandimeve të ZKA-së dhe NJAB;<br>Mbajtja e takimeve periodike për vlerësimin e zbatimit të rekomandimeve, | |
| 1.3.2 Monitorim në aktivitetet e auditimit | Janar 2021 - tetor, 2021 | **Komuna:** Udhëheqësi i NJAB-së dhe kryesuesi i komitetit të auditimit<br>USAID TEAM: C1, NjKA | Menaxhmenti i komunës, NJAB, KKA, drejtoritë/njësit komunale të cilat kanë rekomandime nga ZKA, NJAB dhe anëtarët e KPF. | Rritja e nivelit të zbatimit të planit vjetor të NjAB dhe forcimi i NJAB dhe KKA | |
| 1.3.4. Shpërndarja e praktikave dhe proceseve për të zhvilluar kapacitetet e NJAB dhe KKA | Maj 2021 - shtator | **Komuna**: Udhëheqësi i NJAB-së dhe kryesuesi i Komitetit të Auditimit | Udhëheqësi i NJAB-së dhe kryesuesi i komitetit të auditimit | Organizimi i dy tryezave për ndarje të praktikave dhe proceseve në ngritje të | Të dhënat e programit, lista e pjesëmarrjes |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | 2021 | USAID TEAM: C1,<br>NjKA | | kapaciteteve të NJAB dhe KKA | |
| 1.4 PËRKRAHJA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE KOMUNALE | | | | | |
| 1.4.1 Monitorim i aktiviteteve në menaxhim të burimeve njerëzore dhe implementim të kodit të etikës, instrumenteve/mekanizmave nga ciklet e mëhershme të projektit | Janar 2021 - tetor, 2021 | **Komuna**: Udhëheqësi i BNJ<br>**USAID TEAM:** C1,<br>NjKA | Zyrtarët e BNJ | Implementimi i Kodit Komunal të Etikës | |
| 1.4.2 Shpërndarja e praktikave dhe proceseve të mira në menaxhimin e burimeve njerëzore. | Maj 2021 | **Komuna:** Udhëheqësi i zyrës së BNJ në komunë<br>**USAID TEAM:** C1,<br>NjKA | Menaxherët e zyrave komunale të BNJ | Organizimi i një tryeze për ndarje të praktikave dhe proceseve në menaxhim të BNJ, | Të dhënat e programit, lista e pjesëmarrjes |
| 1.5 RRITJA E TRANSPARENCËS KOMUNALE | | | | | |
| 1.5.1 Monitorimi i aktiviteteve të transparencës komunale | Janar 2021 - tetor, 2021 | **Komuna**: Udhëheqësi i zyrës komunale për informim<br>USAID TEAM: C1,<br>NjKA | Zyrtarët për informim publik, zyrtarët e prokurimit, zyrtarët e IT-së, shefi i kabinetit të kryetarit, sekretaria e kuvendit, ZKF, drejtori i financave | Publikimi i rregullt i dokumenteve dhe raporteve në uebsajtin e komunës nga fushat e financave (korniza buxhetore afatmesme komunale KBAK, buxheti, raportet/rishikimet vjetore, mujore, tremujore dhe vjetore),<br>Raporti i ZKA-së,<br>Prokurimi (Plani i Prokurimit, kontratat e prokurimit dhe dokumentet tjera të | E-Prokurimi, uebsajtet e Komunave |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | prokurimit publik), Plani i Punës së Zyrës së Kryetarit dhe raportet periodike dhe vjetore). | |
| 1.5.2 Përkrahje në zhvillimin, ndërtimin dhe zbatimin e mekanizmave (PSO, doracak-manual, forma-shabllone, etj.) në transparencën komunale | Janar 2021 - tetor, 2021 | **Komuna**: Udhëheqësi i zyrës komunale për informim<br>USAID TEAM: C1, NjKA | Zyra komunale për informim dhe grupi punues | Implementimi i strategjisë për komunikim | |
| 1.5.3 Shpërndarja e praktikave dhe proceseve të mira në transparencën komunale | Prill 2021 – gusht 2021 | **Komuna**: Udhëheqësi i zyrës komunale për informim<br>USAID TEAM: C1, NjKA | Udhëheqësit e zyrave komunale të informimit | Dy tryeza të rrumbullakëta për transparencë janë mbajtur me drejtuesit e ZIP nga të gjitha komunat e Kosovës | Të dhënat e programit, lista e pjesëmarrjes |
| 1.6 PËRMIRËSIMI I MENAXHIMIT FINANCIAR DHE KONTROLLIT | | | | | |
| 1.6.1 Përkrahje në vend pune për proceset e menaxhimit të financave publike | Janar 2021 – Dhjetor 2021 | **Komuna:** Drejtori i financave dhe ZKF<br>**USAID TEAM:** C1, NjKA | Drejtoria e financave dhe të gjitha njësitë e kërkesave në komunë | Rritja e përqindjes së ekzekutimit të pagesave brenda afatit ligjor, dhe<br>Rritja e përqindjes së adresimit të rekomandimeve financiare të ZKA dhe NJAB. | |
| 1.6.2. Monitorimi i aktiviteteve për proceset e menaxhimit të financave publike | Janar 2021 – Dhjetor 2021 | **Komuna:** Drejtori i financave dhe ZKF<br>**USAID TEAM:** C1, NjKA | Drejtoria e financave, të gjitha drejtoritë dhe zyrat e komunës | Pyetësori i plotësuar i vetëvlerësimit<br>Zbatimi i mekanizmave të zhvilluar financiarë: Libri i proceseve, manualeve/PSO-ve<br>Buxheti komunal i zhvilluar për vitin 2022. | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 1.6.3 Përkrahje në zhvillimin, ndërtimin dhe zbatimin e mekanizmave (PSO, doracak-manual, forma-shabllone, etj.) financiare | Janar 2021 – Dhjetor 2021 | **Komuna:** Drejtori i financave dhe ZKF **USAID TEAM:** C1, NjKA | Drejtor i financave, ZKF dhe grupi punuesve | PSO të zhvilluara | |
| 1.6.4 Shpërndarja e praktikave të mira për menaxhimin dhe kontrollin financiar | Prill 2021 – Shtator 2021 | **Komuna**: Drejtori i financave dhe ZKF USAID TEAM: K1, NjKA, AKK, | Drejtorët komunal të financave dhe ZKF-të | Dy tryeza me qëllim të ndarjes së përvojave në ZKF dhe kontrollit | Të dhënat e programit, lista e pjesëmarrjes |